



---

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të neneve 3.5 pika (ii), 15.1 pika (a), (d) dhe (e), 21.2, 37, 38, 39, 52, 53 dhe 54 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Viti III, Nr. 28, datë 4 qershor 2008),

Duke marrë parasysh,

Obligimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës në lidhje me Marrëveshjen Shumëpalëshe për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (më tutje referuar si "Marrëveshja për HPEA") që nga hyrja e saj e përkohshme në fuqi për Kosovën më 10 tetor 2006;

Rregulloren e AAC-së Nr. 3/2009 të datës 30 tetor 2009, e cila zbaton në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës Rregulloren (EC) Nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 20 shkurt 2008 për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimin e Agjencisë Evropiane për Sigurinë në Aviacion;

Rregulloren e AAC-së Nr. 7/2009 të datës 12 nëntor 2009, për kushtet dhe procedurat e përvetësimit, lëshimin, ripërtëritjen dhe zgjatjen e licencave dhe autorizimeve të stafit të aviacionit - pilotëve të aeroplanëve;

Rregulloren e AAC-së Nr. 1/2010 të datës 15 janar 2010, për kërkesat mjekësore për licencimin e ekuipazhit të fluturimit;

Rregulloren e AAC-së Nr. 4/2010 të datës 10 tetor 2010, për kushtet dhe procedurat për përvetësimin, lëshimin, ripërtëritjen dhe zgjatjen të licencave dhe autorizimeve të stafit të aviacionit - pilotëve të helikopterëve;

Udhëzimin Administrativ të AAC-së Nr. 1/2011 të datës 23 shkurt 2011, mbi procedurat për emërimin e Qendrave Mjekësore të Aviacionit (AMC) dhe ekzaminuesve të autorizuar mjekësor (AME),

Me qëllim të zbatimit të Rregullores së Komisionit (EU) Nr. 1178/2011 të datës 3 nëntor 2011, që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me personelin e ekuipazhit ajror të aviacionit civil, mbështetur në Rregulloren (EU) Nr.

216/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të ndryshuar me Rregulloren e Komisionit (EU) Nr. 290/2012, të datës 30 mars 2012; Rregulloren e Komisionit (EU) Nr. 70/2014, të datës 27 janar 2014 dhe Rregulloren e Komisionit (EU) Nr. 245/2014, të datës 13 mars 2014 në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës,

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik me të gjitha palët e interesuara në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2012 për konsultimin publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

**RREGULLORE Nr. 5/2015**  
**E CILA PËRCAKTON KËRKESAT TEKNIKE DHE PROCEDURAT**  
**ADMINISTRATIVE NË LIDHJE ME EKUIPAZHIN AJROR TË AVIACIONIT CIVIL**

**Neni 1**

Kjo Rregullore përcakton rregullat e detajuara për:

- 1) gradimet e ndryshme për licenca të pilotëve, kushtet për lëshimin, mbajtjen, ndryshimin, kufizimin, pezullimin ose revokimin e licencave, privilegjet dhe përgjegjësitë e bartësve të licencave, kushtet për konvertimin e licencave ekzistuese kombëtare të pilotëve dhe licencave ekzistuese kombëtare të inxhinierëve të fluturimit në licenca të pilotëve, si dhe kushtet për pranimin e licencave nga vendet e treta;
- 2) certifikimin e personave përgjegjës për ofrimin e trajnimeve të fluturimit ose trajnimin në simulator të fluturimit dhe për vlerësimin e shkathtësive të pilotëve;
- 3) certifikatat e ndryshme mjekësore për pilotë, kushtet për lëshimin, mbajtjen, ndryshimin, kufizimin, pezullimin ose revokimin e certifikatave mjekësore, privilegjet dhe përgjegjësitë e bartësve të certifikatave mjekësore si dhe kushtet për konvertimin e certifikatave mjekësore kombëtare, në certifikata mjekësore gjerësisht të njohura;
- 4) certifikimin e ekzaminuesve aero-mjekësorë, si dhe kushtet në të cilat mjekët e praktikës së përgjithshme mund të veprojnë si ekzaminues aero-mjekësorë;
- 5) vlerësimin periodik aero-mjekësor të anëtarëve të kabinës së fluturimit, si dhe kualifikimet e personave përgjegjës për këtë vlerësim;

- 6) kushtet për lëshimin, mbajtjen, ndryshimin, kufizimin, pezullimin ose revokimin e vlerësimeve të ekuipazhit të kabinës, si dhe privilegjet dhe përgjegjësitë e bartësve të vlerësimeve të ekuipazhit të kabinës;
- 7) kushtet për lëshimin, mbajtjen, ndryshimin, kufizimin, pezullimin ose revokimin e certifikatës të organizatave për trajnimin e pilotëve dhe të qendrave aeromjekësore të përfshira në kualifikimin dhe vlerësimin aeromjekësor të ekuipazhit ajror të aviacionit civil;
- 8) kushtet për certifikimin e pajisjeve trajnuese për simulimin e fluturimit dhe për organizatat të cilat operojnë dhe përdorin këto pajisje;
- 9) kushtet për administrimin dhe sistemin e menaxhimit të cilat duhet të plotësohen nga Shtetet Anëtare, Agjencia si dhe organizatat në lidhje me rregullat e referuara në pikat 1 deri në 8;

## **Neni 2**

2.1 Rregullorja e Komisionit (EU) Nr. 1178/2011 e datës 3 nëntor 2011 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me personelin e ekuipazhit ajror të aviacionit civil, mbështetur në Rregulloren (EU) Nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e ndryshuar me:

- Rregulloren e Komisionit (EU) Nr. 290/2012 e datës 30 mars 2012 e cila ndryshon Rregulloren (EU) Nr. 1178/2011 e cila përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil në bazë të Rregullores (EU) Nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit,
- Rregulloren e Komisionit (EU) Nr. 70/2014 e datës 27 janar 2014 e cila ndryshon Rregulloren (EU) Nr. 1178/2011 e cila përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil në bazë të Rregullores (EC) Nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit,
- Rregulloren e Komisionit (EU) Nr. 245/2014 e datës 13 mars 2014 e cila ndryshon Rregulloren e Komisionit (EU) Nr. 1178/2011 e cila përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil,

me tutje e referuar si "Rregullorja e Komisionit", shpallet e zbatueshme në Republikën e Kosovës. Rregullorja e Komisionit i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje si shtojcë dhe formon pjesën e saj përbërëse.

2.2 Dispozitat e zbatueshme të Rregullores së Komisionit janë nenet 1-11 si dhe Shtojcat I-VII, ashtu siç janë ndryshuar me rregulloret e përmendura në paragrafin 1.

2.3 Çdo dispozitë e amendamenteve të ardhshme të Rregullores së Komisionit, pasi të bëhet pjesë e Shtojcës I ose II të Marrëveshjes për HPEA, do të jenë të zbatueshme drejtpërsëdrejti në Republikën e Kosovës.

### **Neni 3**

3.1 Kuptimi i shprehjeve dhe definicioneve të përdorura në këtë Rregullore janë të përfshira në Nenin 2 të Rregullores së Komisionit.

3.2 Pavarësisht nga paragrafi më sipër, shprehjet "Komuniteti", "ligji i Komunitetit", "legjislacioni i Komunitetit", "Instrumentet e Komunitetit", "Traktati i KE", "aeroport i Komunitetit", "Gazeta Zyrtare e Komuniteteve Evropiane", "Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian", "transportues ajror i Komunitetit" dhe "Shtet(e) Anëtar(e)", të cilat mund të referohen në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi në Rregulloren e Komisionit, duhet të lexohen në përputhje me Pikat 2 dhe 3 të Shtojcës II të Marrëveshjes për HPEA.

3.3 Për qëllim të kësaj Rregulloreje, shprehja "autoriteti kompetent", "autoriteti i duhur", siç është e referuar në Rregulloren e Komisionit, për organizata të cilat veprimtarinë kryesore të biznesit e kanë në Republikën e Kosovës, do të nënkuptojë Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës; ose "Agjencinë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit" (më tutje e referuar si "Agjencia") nëse kjo kërkohet nga Republika e Kosovës.

### **Neni 4**

4.1 Mënyrat e Pranueshme të Përshtatshmërisë (AMC) dhe Materialet Udhëzuese (GM) të përcaktuara me Vendimet e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Nr.: Vendimi DE 2011/016/R i datës 15 dhjetor 2011; Vendimi DE 2014/022/R i datës 1 prill 2014; Vendimi DE 2011/015/R i datës 15 dhjetor 2011; Vendimi DE 2013/016/R i datës 8 gusht 2013; Vendimi DE 2012/005/R i datës 19 prill 2012; Vendimi DE 2012/006/R i datës 19 prill 2012; Vendimi DE 2013/006/R i datës 16 prill 2013; Vendimi DE 2014/020/R i datës 1 prill 2014; Vendimi DE 2012/007/R i datës 19 prill 2012; Vendimi DE 2013/008/R i datës 16 prill 2013; Vendimi DE 2014/021/R i datës 1 Prill 2014; siç mund të ndryshohen.

4.2 Specifikimet e certifikimit (CS) të përcaktuara me Vendimet e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Nr.: Vendimi DE 2012/010/R i datës 4 prill 2012; Vendimi DE 2012/011/R i datës 26 qershor 2012, do të zbatohen derisa udhëzime tjera të cilat rregullojnë këtë fushë të publikohen.

4.3 Mënyrat e Pranueshme të Përshtatshmërisë (AMC), Materialet Udhëzuese (GM) dhe Specifikimet e Certifikimit (CS) të referuara në paragrafët 4.1 dhe 4.2 janë të publikuara në faqen e internetit të Agjencisë.

### **Neni 5**

Në rast të interpretimit të Rregullores së Komisionit versioni original në gjuhën angleze siç është i publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian do të përdoret.

### **Neni 6**

Kjo Rregullore shfuqizon Rregulloren e AAC-së Nr. 7/2009 të datës 12 nëntor 2009 mbi Kushtet dhe procedurat për përvetësimin, lëshimin, rinovimin dhe rizgjatjen e licencave dhe autorizimeve për stafin e aviacionit - pilotët e aeroplanëve; Rregulloren e AAC-së Nr. 1/2010 të datës 15 janar 2010 mbi Kërkesat mjekësore për licencimin e ekuipazhit të fluturimit; Rregulloren e AAC-së Nr. 4/2010 të datës 10 tetor 2010 mbi Kushtet dhe procedurat për përvetësimin, lëshimin, rinovimin dhe rizgjatjen e licencave dhe autorizimeve për stafin e aviacionit - pilotët e helikopterëve; dhe Urdhëresën Administrative të AAC-së Nr. 1/2011 të datës 23 shkurt 2011 mbi Procedurat për emërimin e Qendrave Mjekësore të Aviacionit (AMCs) dhe ekzaminuesve të autorizuar mjekësorë (AME).

### **Neni 7**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas nënshkrimit të saj.

Prishtinë, 8 korrik 2015

**Dritan Gjonbalaj**  
Drejtor i Përgjithshëm